

20150100169

**LIGJ PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË TË OBLIGIMEVE SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR REHABILITIMIN E RRUGËVE MAGJISTRAL
DHE RAJONALE, QË DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM - BANKËS BOTËRORE DHE NDËRMARRJES
PUBLIKE PËR RRUGË SHTETËRORE**

Neni 1

Në Ligjin për plotësimin e Ligjit për garanci të Republikës së Maqedonisë të obligimeve sipas Marrëveshjes për hua për financimin e Projektit për rehabilitimin e rrugëve magjistrale dhe rajonale, që do të lidhet ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Bankës Botërore dhe Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 116/14), pas nenit 5 shtohet neni i ri 5-a, si vijon:

"Neni 5-a

Qarkullimi i të mirave dhe shërbimeve i kryer ndaj Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, të dedikuara për realizimin e Projektit për rehabilitimin e rrugëve magjistrale dhe rajonale, të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar me të drejtën e heqjes së tatimit paraprak.

Importi i të mirave/shërbimeve nga Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore, të dedikuara për realizimin e Projektit për rehabilitimin e rrugëve magjistrale dhe rajonale, të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe detyrime tatimore, si dhe nga akciza gjatë importit të automobilave dhe vajrave minerale.

Për qarkullimin e kryer ndaj Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, për qëllime të realizimit të Projektit për rehabilitimin e rrugëve magjistrale dhe rajonale, të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji, për të cilin i njëjti është obligues tatimor sipas nenit 32 pika 4 dhe nenit 32-a të Ligjit për tatim mbi vlerën e shtuar, lirohet nga obligimi për llogaritjen dhe pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar.

Obliguesi tatimor që kryen qarkullim lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar sipas paragrafit (1) të këtij neni, detyrimisht përveç emrit (emërtimit) të pranuesit të së mirës ose shfrytëzuesit të shërbimit, në faturë i shënon edhe emërtimin e projektit edhe emërtimin e Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji.

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore gjatë importit të të mirave të liruara sipas paragrafit (2) të këtij neni, organit kompetent doganor detyrimisht i dorëzon kopje të Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji dhe deklaratë se të mirat/shërbimet e importuara janë të dedikuara për realizimin e Projektit për rehabilitimin e rrugëve magjistrale dhe rajonale, të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".